

Relacion per degjese me publikun “Balcan Zoo Farm” Sh.p.k.

Kompania “Balcan Zoo Farm” me seli ne Gjirokaster, Tepelene, Zona Industriale dhe ish Zdruktharia, Zona Kadastrale Nr. 3574, Nr. Pasurisë 2026, ushtron aktivitetin ne Tirane, ne Komunen Vaqarr, Zona Damjan, Godinë 2 Katëshe, në Zonën Kadastrale 1441, Nr. Pasurisë 15/9. Terreni eshte i fushor. Zona perreth dominohet nga toka te lena djerre e te pa shfrytezuara. Rruga kyesore lidhet me rruget hyrese dhe dalese te sistemuara dhe me hapësire per manovrimin e automjeteve. Infrastruktura egzistuese eshte e lidhur me infrastrukturen e zones.

Aktualisht aktiviteti eshte i pajisur me nje leje te tipit C per prodhimin e pijeve, ushqimeve dhe veprimtarite e lidhura me to (ID 7.7/a dhe ID 7.7/b) si dhe me licenca per: Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Tregtia me shumicë e kafshëve të gjalla; Formim profesional;

Kompania do te pajiset me leje te tipit B pasi do te kryeje aktivitetet e ndryshme te klasifikuara ne tabelen e meposhteme sipas ligjit te lejeve.

		ID	Veprimtaria	A	B	C	Shenime
1	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	a. Thertore			Kapaciteti prodhues i karkasave është i barabartë me 5 tonë në ditë ose më pak se kaq.	
2	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	b. Asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve, me mënyra të tjera përveç shndërrimit ose incinerimit, të përmendura në ndonjë veprimtari tjetër të kësaj shtojce.		Kapaciteti i trajtimit është i barabartë me 10 tonë/ditë ose më pak se kaq karkasa të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë.		
3	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e	7.7	c. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme përprodhimin e ushqimeve nga			Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë	

	lidhura me to		lëndët e para nga kafshët (përveç qumështit)			me 5 tonë/ditë ose më pak	
4	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	f. Trajtim ose magazinimin i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve		Të gjitha instalimet		
5	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	l. Prodhim i ushqimit për kafshë		Të gjitha instalimet		
6	Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	o. Magazinimi frigoriferik i produkteve ushqimore të ambalazuara			Për magazina frigoriferike me kapacitetmagazinues mbi 20 tonë	
7	Menaxhimi i mbetjeve	5.10	b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart		Të gjitha instalimet		
8	Blegtoria	7.8	c. Rritje intensive e derrave në një instalim		750 – 100 (kokë) vende për dosa	Barabartë me 100 (kokë) vende për dosa ose më pak se kaq	

Aktivitetet subjekt te ligjit te lejeve jane:

Mbajtja e derrave ne stalle per thertoren

Mbajtja e derrave realizohet ne stalla me nje teknokogji bashkekohore konform legjislacionit ne fuqi dhe duke zbatuar teknikat me te mira te disponueshme. Fale impenjimit te vazhdueshem te kompanise dhe dedikimit te saj ne blegtorine bashkekohore ky aktivitet eshte bere i njohur lokalisht si lider ne kete sektor.

Stallat janë projektuar posacerisht për këto funksione duke patur parasysh kërkesat dhe nevojat e posacme që sjell ushtrimi i aktivitetit. Ato menaxhohen nga personel i kualifikuar dhe që në fazat e projektimit të tyre janë marrë parasysh të gjitha aspektet logjistike e mjedisore të këtij lloji të aktivitetit. Stallat janë projektuar për një kapacitet nën 100 krere.

Thertore

Në shërbim të aktivitetit të kompanisë është edhe thertorja e këtij aktiviteti. Kjo thertore është projektuar dhe ndërtuar në baze të teknikave më të mira të disponueshëm. Ajo është pjesë e funksionimit të integruar të këtij aktiviteti. Thertorja mbahet në funksionim nga personeli i kualifikuar dhe i trajnuar për këto funksione. Kjo thertore është projektuar gjithashtu duke patur parasysh edhe praktikën më të mira mjedisore.

Magazini frigoriferik

Në funksion të aktivitetit të integruar të këtij kompleksi janë edhe dhomat frigoriferike. Ato janë të lidhura ngushtë me aktivitetin e thertores. Ato janë dhoma frigoriferike me shkallë të ulët ftohjeje. Për llojin e aktivitetit nevojitet edhe ngrirje e thellë. Dhomat frigoriferike janë projektuar dhe ndërtuar në funksion të këtij kompleksi. Mirëmbajtja e tyre bëhet vetëm nga personeli i kualifikuar.

Prodhimi i ushqimit për kafshë

Në brendësi të kompleksit ndodhet edhe ambienti për përgatitjen e ushqimit të kafshëve. Derrat dhe dosat e moshave të ndryshme kanë nevojë për ushqime specifike me raporte të ndryshëm përberësish. Përzjerja e këtyre ushqimeve realizohet në kapanonin e prodhimit të ushqimit të kafshëve sipas nevojave të kompleksit. Në këtë repart realizohet vetëm përzjerja e ushqimeve dhe jo prodhimi i tyre.

Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët

Kjo fazë e aktivitetit është akoma në projektim. Është projektuar funksionimi i repartit për prodhimin e sallameve dhe produkteve të tjera ushqimore me baze mishi. Funksionimi i këtij reparti do të jetë pjesë e ciklit të mbyllur të funksionimit të kompleksit blegtoral. Edhe ky aktivitet do të bazohet në teknikat më të mira të disponueshme dhe në teknologjinë bashkëkohore.

Asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve, me mënyra të tjera përveç shndërrimit ose incinerimit

Kompania synon të trajtojë mbetjet e kafshëve të prodhuara nga ajo vetë dhe nga aktivitetet e tjera të ngjashme. Për këtë qëllim ajo do të vete në përdorim një impiant të trajtimit të fundit të mbetjeve nga kafshët. Ky impiant do të funksionojë për trajtimin e kësaj rryme specifike mbetjesh. Kompania do të ngrejë rrejtin e vet të transportit të këtyre llojeve mbetjesh specifike. Ky shërbim do të jetë subjekt i licensimit III.2.B. Në aktivitet do të kryhet për këtë shërbim edhe magazinimi i përkohshëm i mbetjeve jo të rrezikshme në një stacion të transferimit për mbetje jo të rrezikshme deri në momentin e trajtimit në impiantin e mesipër.

